



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Departamenti për Profesione të Lira-Departmentant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.06/2022

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, znj. Diellza Hoxha dhe z. Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbarueses private, znj. [Name], si organ përmbarues e emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në [Location], e dyshuar për shkelje disiplinore lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën përmbarimore, P. nr 293/2021, pas mbajtjes së seancën dëgjimore publike në të cilën prezantuan përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë - Departamentit për Profesione të Lira - Divizionit për Noterinë dhe Përmbarimin Privat znj. Fadilete Hoxha dhe përmbaruesja private znj. [Name]. Me datën 05.04.2022, mori si në vijim:

V E N D I M

REFUZOHET Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-04/2022, i datës 23.02.2022, dhe ankesa e paraqitur nga ana e palës ankuese z. [Name] me datën 22.02.2022, përkatësisht datës 23.02.2022, si jo lëndore.

A R S Y E T I M

Me datën 22.02.2022, përkatësisht datën 23.02.2022, pala ankuese z. [Name] ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë ndaj përmbarueses private znj. [Name] e emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në [Location]. Pala ankuese pretendon që përmbaruesja private znj. [Name] me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përmbarimore në lëndën P. nr 293/2021 ka bere një varg shkeljesh të procedurave të përmbarimit në kundërshtim me Ligjin për Procedurën Përmbarimore ashtu që pas pranimit të propozimit për përmbarim nga pala kreditore - kompania "[Name]", me datën 07.02.2022 ka lejuar përmbarimin ndaj palës debitore z. [Name] për një borxh fiktiv në shumën prej 404.74 euro. Pala ankuese pretendon se përmbaruesja private znj. [Name] ka marr vendim duke e ditur që urdhri përmbarimor nuk është i ligjshëm ngase dokumenti në bazë të cilit është lëshuar urdhri për përmbarim nuk është dokument përmbarimor dhe nuk ka titull ekzekutiv ngase fatura është lëshuar nga kompania private "[Name]" e cila kompani nuk ka autorizim ligjor për lëshimin e faturave. Fatura nuk është pranuar dhe nënshkruar nga debitori, shuma e prezantuar nga kreditori është fiktive,

faturimi është bërë nga kreditori në mënyrë të kundërligjshëm ngase i njëjti ka faturuar edhe për ujin e pijes i cili është në kundërshtim me ligjin për shkak se i vetmi institucion që ka të drejtë të furnizon dhe faturon për ujin e pijes është Ndërmarrja Publike Rrjedhimisht, pala ankuese kërkon që ndaj përmbarueses private znj. [] të ndërmerren veprime ligjore.

Me datën 03.03.2022, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, ka paraqitur në Komision Raportin për Përfundimtar ndaj përmbarueses private znj. [] si organ përmbarues i emëruar për Territorin e Gjykatës Themelore në [], lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën përmbarimore P. nr 293/2021.

Përmbaruesja private znj. [], në përgjigjen e saj thekson se lidhur me pretendimet e ngritura nga pala ankuese është paraqitur prapësim, rrjedhimisht është kompetencë e Gjykatës që të vendos. Për sa i përket faturës, përmbaruesja private thekson që e njëjta është në origjinal e jo në kopje siç pretendon pala ankuese, përkundër që - ndryshe nga dokumentet përmbarimore për të cilat kërkohet që ato të jenë në origjinal apo kopje të vërtetuar- për dokumentet e besueshme nuk ekziston një kërkesë e tillë sipas nenit 38 par 1 të LPP-së. Fatura sipas përmbarueses private është pranuar nga pala ankuese siç e pohon edhe ai vet. Ndërsa lidhur me faktin se pala ankuese nuk ka kontratë të nënshkruar me këtë kompani, ekziston një para kontratë noteriale për Shitblerjen e Banesës, me njërin nga aksionarët kryesor të kësaj kompanie, në të cilën parashihet që *“Blerësi është i obliguar që të paguajë shumën prej 12.00 euro në muaj, për mirëmbajtje të objektit, që nga marrja në shfrytëzim të banesës.”* Për sa i përket dërgimit të shkresave të lëndës, përmbaruesja private thekson se ato i janë dorëzuar përmes Postës së Kosovës në adresën e debitorit dhe siç konstatohet nga provat e bashkangjitura-zarfi i kthyer nga Posta me konstatimet *“për nesër”* dhe *“me raport”* konstatim ky i cili që bënë të kuptohet apo të supozohet (meqenëse përmbaruesit privat nuk janë hetues ta konfirmojnë këtë) se zyrtari i Postës ia ka lënë njoftimin debitorit, që brenda afatit të përcaktuar në të, mund ta tërheq dërgesën nga Posta por për arsye të pa njohura, zarfi nuk është tërhequr nga debitori.

Me datën 05.04.2022, Komisioni Disiplinor ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, znj. [] në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, si dhe përmbaruesja private, znj. [] ndërsa pala ankuese nuk ka marrë pjesë.

Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, ka bërë shtjellimin e Raportit përfundimtar. Po ashtu, përmbaruesja private znj. [] ka ngelur pranë përgjigjes së paraqitura me shkrim.

Pas seancës dëgjimore dhe dëgjimit të palëve, Komisioni Disiplinor me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar në mënyrë shteruese gjitha pretendimet e palëve dhe ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim që përmbaruesja private, znj. [] nuk është përgjegjëse për shkelje disiplinore.

Komisioni Disiplinor gjen me rëndësi të thekson që pala ankuese ngrit dy çështje themelore në këtë procedurë disiplinore. Çështja e parë lidhet me dërgimin e shkresave palës ankuese, ndërsa çështja e dytë ka të bëjë me kontestimin nga pala debitorë përkatësisht pala ankuese të detyrimit i cili rrjedh nga fatura.

Për sa i përket dërgimit të shkresave të lëndës, përkatësisht urdhrin përmbarimor, Komisioni Disiplinor gjen se edhe pse përmbaruesja private znj. ... i kishte dorëzuar urdhrin përmbarimor përmes Postës së Kosovës në adresën e debitorit, pala ankuese nuk kishte pranuar të njëjtin. Siç e pohon vet përmbaruesja private znj. ... nga provat e bashkangjiturazarfii i kthyer nga Posta i cili përmban konstatimin “për nesër” dhe “me raport” vërtetohet që zyrtari i Postës së Kosovës ia ka lënë njoftimin debitorit, që brenda afatit të përcaktuar në të, mund ta tërheq dërgesën nga Posta por për arsye të pa njohura, zarfi nuk është tërhequr nga debitori. Kjo do të thotë që përmbaruesja private znj. ... ishte në dijeni që pala debitore përkatësisht këtu pala ankuese nuk kishte pranuar urdhrin përmbarimor. Megjithatë, në rastin konkret, përmbaruesja private znj. ... në momentin kur ishte kontaktuar nga pala ankuese, e njëjta kishte “hapur zarfin” i kishte dorëzuar urdhrin përmbarimor personalisht, kishte dhënë palës ankuese udhëzimet për mjetin juridik, duke i mundësuar të njëjtit që përmes mjetit juridik të adreson pretendimet e tij në gjykatë brenda afateve ligjore. Si rezultat, pavarësisht që dërgimi i urdhrin përmbarimor nuk ishte dorëzuar në mënyrë të rregullt, të drejtat e palës debitore nga veprimet e përmbarueses private znj. ... nuk ishin prekur në ndonjë mënyrë për ushtrimin e mjetit juridik.

Lidhur me detyrimin përkatësisht mungesën e detyrimit mes palëve, pavarësisht që pala ankuese konteston obligimin ndaj palës kreditore, Komisioni Disiplinor gjen që përmbarimi është lejuar mbi bazën e faturës të cilën edhe pse pala ankuese nuk e ka nënshkruar, të njëjten ai nuk e mohon që e ka pranuar. Gjithashtu, pala ankuese nuk mohon që ka pranuar disa nga shërbimet të cilat i ka ofruar kompania “...” pavarësisht që pala ankuese thekson që nuk kanë detyrimin për pagimin e shërbimeve. Po ashtu, pala ankuese ka kontratë të shkruar me ofruesin e shërbimeve siç konstatohet nga shkresat e lëndës. Megjithatë, meqenëse pretendimet e palës kanë të bëjnë me raporte kontraktuese, Komisioni Disiplinor është i kufizuar që të jap ndonjë vlerësim në mungesë kompetence. Kompetenca e Komisionit Disiplinor kufizohet ekskluzivisht në shkeljet disiplinore. Pala ankuese ka shfrytëzuar mjetin juridik për të sfiduar detyrimin që rrjedh nga fatura, dhe rrjedhimisht, është detyrë e gjykatës që të jap vlerësimin e saj përfundimtar lidhur me të. Siç është theksuar edhe në vendime të tjera të Komisionit Disiplinor, Procedurat disiplinore pranë Komisionit Disiplinor nuk janë zëvendësuese të procedurave ligjore sikundër që Komisioni Disiplinor nuk mund të vepron si organ instancional ku palët adresojnë pretendimet ligjore për të cilat vendos gjykata.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr 06/2022, datë 05.04.2022



Kryesues i Komisionit Disiplinor
Adnan ISUFI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.

Faint, illegible text at the top of the page, possibly a header or introductory paragraph.

Main body of faint, illegible text, appearing to be several paragraphs of a letter or report.



Faint, illegible text at the bottom of the page, possibly a signature or footer.